

## KRITIKË E BIBLIOGRAFI

### PALOK DAKA

#### KONTRIBUT PËR BIBLIOGRAFINË E GJUHËSISË SHQIPTARE (VI) (1919 — 1925)

— 1919 —

1061. — BACON, N.T.: Albanians and Basques [Shqiptarët dhe Baskët]. — *THE ADRIATIC REVIEW* Boston, Mass. (USA) Jan.-Feb. 1919, Vol. I, Nr. 5-6, fq. 215-218.  
 Artikull anglisht mbi përhapjen e fjalës *Albany* në vise të ndryshme të Europës dhe mbi disa afri gjuhësore të shqipes me gjuhën baske, veçanërisht në fushën e nyjeve të mbrapme dhe të numrorëve. Jepet edhe etimologjia e fjalës *Geg* nga «gigas» e kjo nga «gigantes».
1062. — DELLA lingua albanese e della sua letteratura, anche in rapporto alle Colonie albanesi d'Italia [Nga gjuha shqipe dhe letratura e saj, edhe në lidhje me Kolonitë shqiptare të Italisë]. — *RASSEGNA ITALO-ALBANESE* Palermo, 25 Novembre 1919, Anno I, Nr. 7, fq. 8.  
 Kronikë mbi fjalimin e mbajtur nga prof. Zef Skiroi, titullar i katedrës së gjuhës shqipe, në çeljen e vjetit akademik 1917-1918 në Institutin Mbr. Oriental të Napolit.
1063. — «DREJTLEV DONJËS» a «Orthodoks». — *DIELLI* Boston, Mass. (USA) July 29, 1919, 11th Year, Vol. XI, Nr. 1633, fq. 2.  
 Mbi zavendësimin e fjalës *orthodoks* me neologjizmin shqip *drejtë-lëvdonjës*.
1064. — DUFOUR, Prof. LOUIS: Stervitjetore e gjuhese frengjisht... Shih Nr. 1024 (1918).
1065. — DUFOUR, Prof. LOUIS: La vetustà della lingua albanese [Lashtësia e gjuhës shqipe]. — *KUVËNDI* Roma 17 Jenar 1919, Vit'i II, Nr. 2 fq. 3.  
 Letër italisht në lidhje me artikujt e botuem, shih Nr. 1023 dhe 1047.
1066. — DUFOUR, Prof. LOUIS: Barfolja, Shtazfolja dhe zogjfolja. — *KUVËNDI* Roma 28 Jenar 1919, Vit'i II, Nr. 3, fq. 3.  
 Botohen disa qinda fjalë shqipe me përkthimin frangjisht (emna bimësh, lulesh e shtazësh) nxjerrë nga fjalori i autorit.
1067. — FLOQI, Dr. KRISTO: Na edhe Gjûha e jonë... Shih Nr. 1029 (1918)
1068. — FLOQI, KRISTO: Panajot Kupitori. — *AGIMI, Shkodër Dhetuer* 1919, Vjet I, Nr. 8, fq. 128-129.  
 Shënime biobibliografike. Theksohet se P. Kupitori, arbënesh i Gre-qisë, ka botue edhe këto vepra: *Studim historik e filologjik për gjuhën*

e kombin e shqyptarve, 1879; *Shenime gramatikale mbi dialektin e shqyptarve të Greqisë*, 1870; *Alfabetarja e gjuhës shqype*, 1879, etj.

1069. — GURAKUQI, KARL: Zhvillimi i gjuhës. — *AGIMI, Shkodër Korrik 1919, Vjet'e I, Nr. 3, fq. 33-36.*  
 Artikull mbi zhvillimin e pabarabartë të gjuhëve dhe mbi ndryshimet dialektore; prek edhe çështjen e gjuhës letrare shqipe, e cila, simbas vendimit të Komisionit letrar të Shkodrës, duhet të jetë në bazë të folmes së Elbasanit.
1070. — JERONIM De Rada. — *POPULLI, Shkodre 5 Dhetuer 1919, Viti I, Nr. 44, fq. 4.*  
 Shënime biografike. (Nxjerrë nga «Kalendari Kombiar»).
1071. — JIREÇEK, Dr. KOSTANDIN: Gjendja e kalueme e qytetit të Durrësit [përkthye nga]: *Karl Gurakuqi*. — *AGIMI, Shkoder Tetuer 1919, Vjet i I, Nr. 6, fq. 91-92; Nr. 7, fq. 104-106; Nr. 8, fq. 122-124; 1920, Vjeti I, Nr. 9, fq. 140-142; Nr. 10, fq. 160-161.*  
 Jepet edhe etimologjia e emnit *Durrës* si dhe të dhana toponimike.
1072. — KOMISIJA LETRARE SHQIPE: Parime e rregulla mbi orthografin e gjuhës shqipe të shkrueme. — *KUVËNDI Roma 31 Mars 1919, Vit II, Nr. 9, fq. 4.*  
 Ribotim (Shih Nr. 1003, pika 3).
1073. — LAJME e zadhanje. — *KOPESHTI LETRAR Elbasan Mars 1919, Vit'i Parë, Nr. 8, fq. 16.*  
 Informacion bibliografik mbi botimin e «Libri i gjuhës a gramatikë» për rendin e III-të të shkollës fillore prej Aleksandër Xhuvanit.
1074. — LAKO [NIKOLLA]: Profesori Jean Brunhes dhe Shqiptarët. — *DIELLI, Boston, Mass. (USA) February 28, 1919, 11th Year, vol. XI, (Nr. 1459 mungon), Nr. 1460, fq. 2.*  
 Përmbledhje e konferencës së mbajtur nga prof. Zhan Bryne mbi shqiptarët (preken edhe çështje të origjinës indoeuropiane të gjuhës shqipe, alfabetet shqipe, etj.).
1075. — L[OGORECI], M[ATI]: Mithologi Komtare (+). — *AGIMI, Shkodër Gusht 1919, Vjet'e I, Nr. 4, fq. 56.*  
 Në shënimin (+) autori shkruen për ortografinë e fjalës *komb*, e cila, simbas tij, duhet shkruet pa b, *kom*.
1076. — L[OGORECI], M[ATI]: Shtjerrtime gjuhe. — *AGIMI, Shkoder Shtatuer 1919, Vjet'e I, Nr. 5, fq. 66-69.*  
 Artikull me vëzhgime të përgjithëshme dhe shënime mbi përdorimin e foljeve të parregullta, mbi praninë e zanoreve të gjata në disa vise të Shqipnisë së Jugut, mbi përemnat; mbi pastërtinë e gjuhës shqipe; mbi disa trajta ortografike, etj. Red. në një shënim të sajën nuk pajtohet me disa nga pohimet e autorit të këtij artikulli.
1077. — L[OGORECI], M[ATI]: Bibliografi «Kopshti Letrar» — E përkohëshme e përmuejshme. — *AGIMI, Shkodër Dhjetuer 1919, Vjet'e I, Nr. 8, fq. 124-125.*

Prek edhe çeshtje të ortografisë si dhe neologjizmin *lemí e lemtar* për komb e kombëtar.

1078. — MITKO, EUTIMIO: Korcia e il suo distretto. Topografia di Korcia (Traduzione dall'albanese). — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia Ottobre 1919, Anno XXIII, Nr. 27, 28 e 29, fq. 1-2.*

Përkthim, marrë nga *Fiámuri Arbënit* (Shih Nr. 11)

1079. — MOSI, HIL: Shtjerrtime mbi gjuhë letrare. — *AGIMI, Shkodër Tetuer 1919, Vjet'i I, Nr. 6, fq. 83-86.*

Vërejtje artikullit të M. Logorecit për fjalën *komb* (shih Nr. 1075). Mendime mbi zgjedhimin e foljeve, mbi disa çeshtje të ortografisë dhe të shumësit të emnavet, të kushtëzuem nga pranimi i vendimit të komisisë letrare për gjuhën letrare të shqipes në bazë të të folmes së Elbasanit.

1080. — NJË LETRË për Vatrën prej Drejtorisë së Arësimit në Berat. — *DIELLI, Boston, Mass. (USA) Séptember 16, 1919, 11th Year, Vol. XI, Nr. 1673, fq. 2.*

Mbi kërkesën e drejtorit të arësimit, Sali Gjukës, drejtue «Vatrës» që të zbatohet në botimet shqipe gjuha e përbashkët, simbas vendimeve të Kongresit të Manastirit dhe të Komisisë Letrare. (Shih edhe Nr. 1085).

1081. — PARIME e rregulla mbi orthografin e gjuhes shqipe te shkrueme. — *PËR-PARIMI, New York (USA) April 1919, Vol. III, Nr. 10, fq. 5-6.*

Ribotim, marrë nga gaz. *Kuvëndi* (Shih Nr. 1072).

1082. — PARIME e Rregulla mbi orthografinë e Gjuhës Shqipe të Shkrueme. — *DIELLI, Boston, Mass. (USA) April 26, 1919, 11th Year, Vol. XI, Nr. 1508, fq. 2.*

Ribotim, marrë nga gaz. *Kuvëndi* (Shih Nr. 1072).

1083. — PETROTTA, Dott. GAETANO: Studi Albanesi [Studime Shqiptare]. — *RASSEGNA ITALO-ALBANESE, Palermo 15 Aprile 1919, Anno I, Nr. 1, fq. 6-8, Nr. 2, fq. 3-7; Nr. 4, fq. 4-7; 1920, Anno II, Nr. 1, fq. 9-13 (vazhdimi mungon).*

Cikël artikujsh italisht mbi *popullin, gjuhën dhe leteraturën shqipe.*

- 1084 — PETROTTA, ROSOLINO: Per l'insegnamento della lingua albanese nelle Colonie albanesi d'Italia [Për mësimin e gjuhës shqipe në Kolonitë Shqiptare të Italisë]. — *RASSEGNA ITALO-ALBANESE, Palermo 15 Aprile 1919, Anno I, Nr. 1, fq. 8-11.*

Artikull italisht mbi iniciativat e marruna herë-mbas-here për ngritjen e shkollave dhe të katedrave të gjuhës shqipe për shqiptarët e Italisë dhe qëndrimin pasiv të qeverisë italiane ndaj këtij problemi.

1085. — PËRMI bashkimin e gjuhës. — *DIELLI, Boston, Mass. (USA) September 19, 1919, 11th Year, Vol. XI, Nr. 1676, fq. 2.*

Mbi përgjigjen e Red. së *Dielli-t* letrës së Sali Gjukës (Shih Nr. 1080) në lidhje me pamundësinë e zbatimit nga Shqiptarët e Amerikës të vendimeve për çeshtjen e gjuhës së përbashkët të shqipes.

1086. — PROF. Louis Dufour. — *DIELLI, Boston, Mass. (USA) April 4, 1919, 11th Year, Vol. XI, Nr. 1490, fq. 1.*

Shënime biobibliografike.

1087. — PROGRAMA e Seminarit të Grottaferrates. — *KUVËNDI Roma 28 Jenar 1919, Vit II, Nr. 3, fq. 4.*  
Shpallet programi mësimor i Seminarit të Grottaferrates (afër Romës) në të cilin përfshihet edhe mësimi i gjuhës dhe i letërsisë shqipe, për rendet I deri në VI.
1088. — SARAVULI, P. (Pseud. i *Pietro Scaglione*): *Istoria e Shqiptarëve Italisë...* Shih Nr. 1005 (1917).
1089. — SCHIRO, PAOLO: «Libri i dom Gjon Buzukut» i shtipur në vitin 1555. — *KUVËNDI Roma 23 Prill 1919, Vit II, Nr. 12, fq. 4.*  
Letër e P. Skiròit mbi përmbajtjen kryesore të veprës së Buzukut, zbulimin e saj nga Nikollë Kazazi (më 1740) dhe qarkullimin e mavonshëm të kësaj vepre. Në fund njoftohet se vepra e Buzukut do të dërgohet në shtyp me shënimet përkatëse (në fq. 3 jepet edhe italisht: *Il «Libro di don Gion Buzuku» stampato nel 1555*).
1090. — SELENITZA, TEHI: Çelia e klubit Bashkimi në Berat (Korrespondencë e veçantë). — *KUVËNDI Roma 16 Maj 1919, Vit II, Nr. 15, fq. 3.*  
Mbi themelimin me 4 maj 1919 në Berat të Klubit «Bashkimi», i cili do të punojë për lulëzim e përparim të gjuhës.
1091. — SHKRIMI e Alfabeti Shqiptar. Shtudim. — *POPULLI, Shkodrë 14 Fruer 1919, Vit'i I, Nr. 7, fq. 3-4; Nr. 8, fq. 3-4; Nr. 10, fq. 3-4; Nr. 11, fq. 3-4; Nr. 13, fq. 4 (vazhdimi ndërpritet).*  
Studim i ndamë në dy kapituj: I. *Historia e Shkrimit*, e cila nis me sistemin primitiv të shkrimeve të lashta (piktografia) tue ndjek sistemet e ndryshme alfabetike të mavonëshme (ideografik, hieroglifet, etj.); II. *Shkrimi shqiptar* nis me alfabetin e vjetër [sic] të zbuluem prej Dr. G. Hahnit.
1092. — SHKRIMI Shqip. — *OPINGA Boulogne (Seine) France 1 Dhjetor 1919, Mot'i parë, Nr. 1, fq. 13-18; 1920, Nr. 2, fq. 30-31.*  
Artikull mbi alfabetin e Theodor Haxhifilipit [i pandehun nga G. Hahni në *Die albanesischen und slavischen Schriften* si alfabet pellazg]. Jepen disa skica e fotokopje të këtij alfabeti dhe të alfabetit të N. Veqilharxhit. Flitet edhe për Autorët e Vjetër të Veriut për Buzukun, Fjalorin e Bardhit [gabimisht i atribuohet Budit], etj.
1093. — SHQIPTARËT. — *DIELLI, Boston, Mass: (USA) February 8, 1919, 10th Year, Vol. X, Nr. 1445, fq. 2.*  
Artikull mbi origjinën trako-ilire të Shqiptarëve. Jepen edhe citate nga Profesor Ripley dhe Dr. Deniker në lidhje me autoktoninë e shqiptarëve (nxjerrë nga e përkohëshmjia *The National Geographical Magazine* e dhjetorit).
1094. — T'A punojmë gjuhën shqipe. — *KUVËNDI, Roma 28 Jenar 1919, Viti II, Nr. 3, fq. 3.*  
Artikull mbi nevojën e pasunimit të gjuhës shqipe simbas shembujllave të K. Kristoforidhit dhe N. Frashërit.
1095. — THALLOCY, Dr. LUDWIG: *Historija e motshme e ilirvet nder vende të Boznisë.* [Paraqitë nga] Hil Mosi. — *AGIMI, Shkodër Maj 1919, Vjet'e*

I, Nr. 1, fq. 14-15; Nr. 2, fq. 22-24; Nr. 3, fq. 37-41; Nr. 4, fq. 51-54; Nr. 5, fq. 71-77.

Përmban të dhana edhe për etnogjenezën dhe gjenezën e gjuhës shqipe si dhe një numër toponimesh.

1096. — TRASHIGIME Pelazgesh — Beet, besimet e do doke tjera mas s'cillash dishmohet vjetersia e komit shqyptar. — *POPULLI, Shkodrë 19 mars 1919, Viti I, Nr. 14, fq. 3-4; Nr. 15, fq. 3-4 (Vazhdimi ndërpritet).*

Të dhana për etnogjenezën. Shih edhe Nr. 1230.

1097. — XHUVANI, ALEKSANDER: *Selectae...* Shih Nr. 1060 (1918).

— 1920 —

1098. — BARDHI, A.P.: Mâ i moçmi alfabet i gjuhës shqype. — *ZANI I SHNA NDOUT, Shkodër Kallnduer 1920, Vjeti VIII, Pjesa e II, Nr. 1, fq. 20-21.*

Shënime për historinë e alfabeve të shqipes: alfabeti i Mesrop Masdotit, i cili, simbas Françesko Tajani, Albert Stratikò, etj. konsiderohej si i pari alfabet i shqipes; mbi alfabetin e Dhaskal Todrit, i pandehun nga G. Hahn si alfabet i lashtë, të cilin G. Majeri e përcakttoi si alfabet origjinal të Dhaskal Todrit [Theodor Haxhifilipit]

1099. — BARDHI, A.P.: Alfabeti i përdoruem prej shkrimtarësh të moçëm t'Gegnis. — *ZANI I SHNA NDOUT, Shkodër Fruer 1920, Vjeti VIII, Pjesa II, Nr. II, fq. 49-51.*

Shënime për historinë e alfabeve të shqipes: alfabetet e Autorëve të Vjetër të Veriut me shkronja latine dhe të Jugut (Grigorit) me shkronja greke.

1100. — BARDHI, A.P.: Alfabetat të përdoruem prej shkrimtarësh shqyptarë t'Italis. — *ZANI I SHNA NDOUT, Shkodër Prill 1920, Vjeti VIII, Pjesa e II, Nr. IV, fq. 102-104.*

Shënime për historinë e alfabeve të shqipes.

1101. — [BARDHI, A.P.]: Naum Veqilharxhi e Anastas Kullurjoti. Alfabeti i Stambollës. — *ZANI I SHNA NDOUT, Shkodër Maj 1920, Vjeti VIII, Pjesa e II, Nr. V, fq. 133-135.*

Shënime për historinë e alfabeve të shqipes.

1102. — BARDHI, A.P.: Shoqnia e «Bashkimit» e shoqnia e «Agimit». Kongresi i Manastirit. Komisjoni letrar. — *ZANI I SHNA NDOUT, Shkodër Qershuer 1920, Vjeti VIII, Pjesa e II, Nr. VI, fq. 153-156.*

Shënime për historinë e alfabeve të shqipes.

1103. — BARDHI, A.P.: Libri i D. Gjon Buzukut. — *ZANI I SHNA NDOUT, Shkodër Fruer 1920, Vjeti VIII, Pjesa e II, Nr. II, fq. 52-53.*

Përshkrim i përgjithshëm i veprës së Gjon Buzukut (nxjerrë nga gaz. *Kuvëndi*, shih Nr. 1089).

1104. — BARDHILI, MUSË: Disa vërejtje mbi Historinë e Gjuhës shqipe. — *MBROJTJA KOMBËTARE, Vlorë 22 Nantuër 1920, Vit'i I, Nr. 7, fq. 2-3 (vazhdimi ndërpritet).*

Artikull divulgativ mbi evolucionin e gjuhëve. Gjuha e lashtë jape-tike (a sanskrite) dhe pozita e shqipes në grupin e gjuhëve indoeuropiane. Tabelë fjalësh shqipe të krahasueme me fjalë të greqishtes, latinishtes e indishtes.

1105. — [BIBLIOGRAFI]: «A. Xhuvani — *Libri i gjuhës* — pjesa e parë — Elbasan, 1919». — *RASSEGNA ITALO-ALBANESE, Palermo 15 Aprile 1920, Anno II, № 2, fq. 32.*

Informacion bibliografik.

1106. — BIBLIOGRAFI: «E drejta themelore» ose konstitucionare (Hukuki — esasije) nga Kristo Floqi, fq. 209 (1920). — *AGIMI, Shkodër Tetuer 1920, Vjeti II, Nr. 6, fq. 91.*

Shënime bibliografike. Vepërza përmban, thuhet në këto shënime, edhe një listë skajesh teknike (terminologji) në gjuhët shqip, greqisht, turqisht e frangjisht.

1107. — CHAPARY, REFO: Per fjalore shqip Shqiptarëvet të Amerikës. — *E VËRTETA (The Truth) St. Louis, Mo., (USA) Sat.-Nov. 6, 1920, First Year, Vol. I, Nr. 5, fq. 1.*

Mbi çeljen e një fushate për botimin e një fjalori të gjuhës shqipe. Në fund jepet edhe një shënim i redaksisë.

1108. — CHINIGO, ALFONSO: Dëgul Variboba. — *KUVËNDI Roma 14 Maj 1920, Vit'i III, Nr. 78, fq. 4; Nr. 79, fq. 3.*

Artikull mbi Jul Varibobën, shkruar në dialektin e arbëneshve të Italisë.

1109. — COSTANTINO Kristoforidhi. — *RASSEGNA ITALO-ALBANESE, Palermo 15 Aprile 1920, Anno II, Nr. 2, fq. 30.*

Shënime biobibliografike mbi K. Kristoforidhin, (nxjerrë nga fjali-mi i Zef Skiroit, shih Nr. 1062).

1110. — DUFUR, Prof. LOVUS [sic]: Thirrje për nevojen e nje fialetoare kombetare shqipe. — *E VËRTETA (The Truth) St. Louis, Mo., (USA) Oct. 16, 1920, First Year, vol. I, Nr. 4, fq. 1.*

Thirrje për hartimin e një fjalori të gjuhës shqipe. (Shih edhe nr. 1107).

1111. — EPIROTI (Pseudonim): Fjalelet Epir dhe Shqipëri janë sinonime. — *DRITA, Gjinokastrë Prill 26, 1920, vol. I, Nr. 5, fq. 3; Nr. 6, fq. 3-4.*

Artikull mbi prejardhjen e fjalës *Epir* dhe identitetin e kësaj fjale me fjalën *Shqipëri*.

1112. — FLETA e Editores. — *YLL'I MENGJEZIT (The Morning Star) Boston, Mass. (USA) April 1920, Vol. 3, Nr. 11, fq. 311.*

Mbi mundësinë e krijimit të një gjuhe letrare të përbashkët të shqipes (§ 4) me anën e lëvizjes së kuadrove arsimore nga jugu në veri e anasjelltas.

1113. — FLOQI, KRISTO: Gjuha shqipe a shkruhej dikur?. — *AGIMI, Shkodër Prill 1920, Vjeti I, Nr. 12, fq. 185-191.*

Artikull mbi lashtësinë e gjuhës shqipe simbas Dr. Sayce, Mesrop Masdoty, G. Hahn, G. Majer, Fr. Tajan, Gerhard, Fabretti, etj. Veçanë-

risht autori ndalet në paraqitjen e veprës së gjermanit Prof. Otto Blau, *Die albanische Sprache als Hilfsmittel zur Erklärung der lykischen Inschriften* (Gjuha shqipe si mjet për spjegimin e mbishkrimeve lyqike) dhe *Die Etruskische Spiegel* (Pasqyrat etrusqike). Riprodhohen mbishkrimet e pesë rrasave të zbulueme në Kretë, të cilat, O. Blau, i deshifron me anën e shqipes.

1114. — FLOQI, Dr. KRISTO: *Kosova* (Serbi e Vjetër!) Studim etnografik e statistik. (Përgjegje z. Prof. Zvijich-it). — *AGIMI, Shkodër Qershuer 1920 Vjetit i II, Nr. 2, fq. 21-24; Nr. 3, fq. 33-36; Nr. 4, fq. 51-52; Nr. 5, fq. 65-68; Nr. 7-8, fq. 108-109; 1921, Nr. 12, fq. 174-176.*

Përmban edhe të dhana për toponomastikën e Kosovës dhe disa etimologji toponimesh.

1115. — FLOQI, Dr. Kr.: A kemi në mythologi?. — *ZANI I SHNA NDOUT, Shkodër Korrik 1920, Vjetit VIII, Pjesa e II, Nr. VII, fq. 179-182; Nr. VIII, fq. 203-206; Nr. IX, fq. 227-250; Nr. X, fq. 254-256.*

Përmban edhe etimologji, simbës teorisë pellazgjike, për fjalët *Haos, Gjea, Erevos, Nyks, Uranos, Thetis, Kronos, Saturn, etj.*

1116. — GURAKUQI, KARL: Fmzot Pjetër Bogdani. — *AGIMI, Shkodër marc 1920, Vjetit I, Nr. 11, fq. 177-179.*

Artikull me shënime biobibliografike mbi Pj. Bogdanin (nxjerrë nga libri i Albert Stratiko). Flitet edhe për themelimin në Shkodër të Shoqnisë «Bogdani», e cila ka për qëllim edhe lavrimin e gjuhës shqipe.

1117. — II. LIBRO di dom Gjon Buzuku stampato nel 1555 (Libri i dom Gjon Buzukut; i shtipur nae vit 1555). — *RASSEGNA ITALO-ALBANESE, Palermo 15 Aprile 1920, Anno II, Nr. 2, fq. 27-28.*

Shënime në dialektin e arbëneshëvet dhe italisht mbi librin e Gjon Buzukut. Riprodhohet një copë nga «Meshari» i Buzukut.

1118. — JIRFCEK, Dr. KOSTANDIN: Gjendja e kalueme e qytetit të Durrsit... *Shih Nr. 1071 (1919).*

1119. — JIRECFK Dr. K.: Vlona në kohë të mesme. [Paraqitë nga] Hil Mosi. — *AGIMI, Shkodër Shtatuer 1920, Vjetit II, Nr. 5, fq. 68-70; Nr. 6, fq. 86-89; vjetit 1921, Nr. 7-8, fq. 110-111; Nr. 11, fq. 161-162; vjetit III, Nr. 1, fq. 10-12; Nr. 8, fq. 151-152; Nr. 9, fq. 164-166.*

Përmban edhe të dhana për toponomastikën.

1120. — MËSONI Shqip! — *E VËRTETA Stamboul (Turqi) 3 Prill 1920; Viti I, Nr. 2, fq. 4.*

Njoftim mbi çeljen e një kursi të gjuhës shqipe në Turqia Han, Nr. 40.

- 1121 — MEYER, GUSTAVO: Arbrëçt. — *KUVENDI Roma 20 Maj 1920, Vit. III, Nr. 79, fq. 3.*

Artikull mbi arbëneshët dhe dialektet e tyre, shkruar në të folmen e arbëneshvet të Italisë (nxjerrë nga *Arbri i Ri* i 1 majit 1887).

1122. — NOTIZIARIO [Lajme]. — *RASSEGNA ITALO-ALBANESE Palermo 15 Aprile 1920, Anno II, Nr. 2, fq. 34.*

Njoftime mbi çeljen (me 11 prill 1920) të një shkolle shqipe në Piana dei Greci me iniciativën e Papas Zef Petta.

1123. — PETROTTA, Dott. GAETANO: Studi albanesi... Shih Nr. 1083 (1919).
1124. — PETROTTA, ROSOLINO: Il problema dell'insegnamento della lingua albanese nelle scuole delle Colonie d'Italia [Problemi i mësimit të gjuhës shqipe në shkollat e Kolonive të Italisë]. — *KUVËNDI Roma 13 korrik 1920, Vit. III, Nr. 82, fq. 1-2.*  
 Autori ngre problemin e futjes së mësimit të gjuhës shqipe nëpër shkollat fillore të komuneve arbëneshe.
1125. — SALIH Nivitza. — *POPULLI, Shkodrë 19 Jenar 1920, Vit'i II, Nr. 50, fq. 1-2.*  
 Nekrologji. Në vitet 1913-1914 S. Nivica ish mësues i gjuhës shqipe në *Robert College* të Stambollit.
1126. — SCHIRO, GIUSEPPE: La terza persona singolare del presente indicativo del verbo albanese *jam* (io sono) [Veta e tretë njejës e deftores së tashme të foljes shqipe *jam*]. — *RASSEGNA ITALO-ALBANESE Palermo 15 Marzo 1920, Anno II, Nr. 1, fq. 10-15 (vazhdimi mungon).*  
 Morfologji historike.
1127. — SHKOLLA Shqip!. — *E VERTETA Stamboul (Turqi) 25 Mars 1920, Viti I Nr. 1, fq. 4.*  
 Njoftime mbi frekuentimin e shkollës shqipe «Feri Qoj» (Turqi).
1128. — SHKOLLA t'ona Kombetare. — *E VERTETA, Stamboul (Turqi) 28 Nëntor 1920 Vit'i I, Nr. 4, fq. 4.*  
 Njoftime mbi shkollat shqipe në kolonitë shqiptare të Stambollit (Feri-Qoj, Beshiktash, Fatih e Ejub).
1129. — SHKRIMI shqip... Shih Nr. 1092 (1919).
1130. — UNA scuola di lingua albanese [Një shkollë e gjuhës shqipe]. — *KUVËNDI Roma 16 Prill 1920, Vit. III, Nr. 76, fq. 2.*  
 Mbi çeljen e një shkolle shqipe në Piana degli Albanesi, me mësues Papas Zef Petta (Shih edhe Nr. 1122).

— 1 9 2 1 —

1131. — BARÇA, KEKINA BIDHERA: Si duhet përkrahë zhvillimi i gjuhës. — *SHKOLLA E RE Shkodër maj 1921, Vjeti I, Nr. 5, fq. 96-98.*  
 Artikull mbi çeshtjen e gjuhës letrare. Propozohet shpallja e një konkursi për shkrimet ma të mira si modele të gjuhës letrare.
1132. — BELKAMENI, M.: Pjesa Literare. — *KOHA, Korçë 20 gusht 1921, Vit'i XII, Nr. 57, fq. 2.*  
 Artikull mbi ndreqje gabimesh ortografike dhe mbi zavendësimin e fjalëve të hueja.
1133. — BIBLIOGRAFI: Libri i Dom Gjon Buzukut, i shtypun në vjetë 1555. — *HYLLI I DRITËS, Shkodër ndanduer 1921, vjeta II, Nr. VII, fq. 330-332.*

Bahet një përshkrim i shkurtër i kësaj vepre; jepen njoftime mbi zbuluesin Gjon Nikoll Kazazin e të tjerë si dhe njoftime mbi përgatitjen për botim të «Mesharit».

1134. — BRATKO, J.: Përdorim i fjalëve. — *KOHA, Korçë 15 Janar 1921, Vit'i XII, Nr. 28, fq. 2.*  
Ortografi e leksik. Mbi zavendësimin e fjalëve *dreq, mbesim, gjëkafshë*, etj. resp. me *drejt, besim, gjësend*.
1135. — DHIMITËR Kamarda (1821-1921). — *HYLLI I DRITËS Shkoder Dhetuer 1921, Vjeta II, Nr. VIII, fq. 356-360.*  
Artikull përkujtimor me shënime biobibliografike me rastin e 100 vjetorit të lindjes së albanologut Dh. Kamarda.
1136. — DUFOUR, Prof. LOUIS: Notes rétrospectives sur les Albanais et la langue Albanaise [Shënime retrospektive mbi Shqiptarët dhe gjuhën shqipe]. — *MBROJTJA KOMBËTARE Vlorë 14 Prill 1921, Vit'i II, Nr. 30, fq. 2.*  
Artikull frangjisht me karakter të përgjithshëm.
1137. — FJALA Pasanik. — *FJAL'E LIR, Vlorë 11 Mars 1921, Viti I, Nr. 3, fq. 2.*  
Diskutim mbi kuptimet e fjalës *pasanik* dhe mbi ortografinë e mbiemnit *i lir* (me apo pa ë).
1138. — FLOQI, Dr. KRISTO: *Kosova* (Serbi e Vjeter!)... Shih Nr. 1114 (1920).
1139. — GJEÇOV, A.K.: Sebaste n'Armeni apo n'Arbëni?. — *ZËNI I SHNA NDOUT Shkodër Maj 1921, Vjeti IX, Nr. V, fq. 72-77; Nr. VIII, fq. 125-128; Nr. IX, fq. 142-144. 1922, vjeti X. Nr. III, fq. 44-48; Nr. IV, fq. 60-63; Nr. V, fq. 76-81; Nr. VI, fq. 98-100; Nr. VII, fq. 114-116; Nr. VIII, fq. 128-131; Nr. X, fq. 160-164.*  
Gjurmime gojdhanaash dhe të dhana historike rreth disa toponimeve të katundeve Laç e Zhejë (Rrethi i Krujës).
1140. — GJUHA e perzjerë. — *DIELLI, Boston, Mass. (USA) February 26, 1921. 13th Year, Vol. XIII, Nr. 2075, fq. 2.*  
Kryeartikull mbi përziemjen e dialekteve të shqipes në dokumentet zyrtare, për mungesë të një gjuhe zyrtare të përbashkët.
1141. — GJUKA, SALI: Bisedim gjuhe mbi ë të mbrame. — *SHKUMINI, Elbasan 16 Shëndré 1921, Viti I, Nr. 42, fq. 2; Nr. 43, fq. 1.*  
Çeshtje ortografie. Mbi përdorimin e ë-s fundore tek disa emna e folje në shqipet.
1142. — GURAKUQI, Pr. KARL: Bisedë Gjuhe *E lirë* apo *E lir*. — *FJAL'E LIR, Vlorë 28 Majë 1921, Viti I, Nr. 14, fq. 3.*  
Çeshtje ortografie. Diskutim mbi përdorimin e ë-s tek emnat e mbiemnat e pashquem femnorë. (Shih edhe Nr. 1137, 1151, 1153). Në një shënim të sajin Red. nuk asht i një mendjeje që të përdoret ë-ja fundore tek emnat e mbiemnat e pashquem emnorë.
1143. — JIREÇEK, Dr. K: *Vlona* në kohë të mesme... Shih Nr. 1119 (1920).
1144. — KËSHILLI I EPËR ARSIMUER: Kritikat «Gjeometri Fillestare prej S. Gjukës e Xh. Belegut». — *KUMTARI ARSIMUER, Tiranë mars 1921, Vit I, Nr. 1, fq. 4-6.*

Bibliografi dhe kritikë mbi ortografinë dhe terminologjinë e përdorun në tekstin e autorëve të sipërm.

1145. — KËSHILLI I EPËR ARSIMUER: Jan K. Minga. Abetare Kombëtare shqip. F. 56. — *KUMTARI ARSIMUER Tiranë Prill 1921, Vit I, Nr. 2, fq. 36-38.*  
Bibliografi dhe kritikë me vërejtje ortografike, morfologjike dhe sintaktike.
1146. — KONGRESI pedagogjik i Lushnjes. — *SHKOLLA E RE Shkodër Kalinduer-Fruer 1921, Vjeti I, Nr. 1-2, fq. 22-26, vv.*  
Vendim mbi caktimin me disa përmirësime të dialektit të Elbasanit si gjuhë letrare të shqipes (me të cilin do të shtypen tekstet shkollore).
1147. — LIPI (Pseud. i Filip Papajanit): Gjuha kombtare. — *SHKUMINI, Elbasan 25 Shkurt 1921, Viti I, Nr. 7, fq. 1.*  
Kryeartikull mbi nevojën e njohjes mirë të gjuhës shqipe nga nëpunësit e naltë të administratës shtetnore.
1148. — L[OGORECI]: Nji rrezik për gjuhë. — *KUMTARI ARSIMUER Tiranë Prill 1921, Vit I, Nr. 2, fq. 26-27.*  
Artikull mbi rruajtjen dhe pastërtinë e gjuhës shqipe nga fjalët e hueja.
1149. — LOGORY, L.D.: Z. Direktor i «Kohës». — *KOHA, Korçë 17 shtator 1921, Vit'i XII, Nr. 61, fq. 1.*  
Vërejtje mbi ortografinë e emnave të përveçëm mashkullorë që mbarojnë me -a (Nikua, Skendua, etj.) dhe mbi parashtesat ç- e sh-.
1150. — MARLASKAJ, P. AMBROZ: Mbi Ortografi të sotshme. — *HYLLI I DRITËS Shkodër korrik 1921, Vjeta e II, Nr. III, fq. 112-118; 1922, vjeta III, Nr. II, fq. 65-70.*  
Artikull me vërejtje dhe shënime rreth ortografisë së adoptueme nga Komisia letrare e Shkodrës.
1151. — MEHQEMEA, RIFAT: Bisedë Gjuhe. — *FJAL'E LIR, Vlorë 2 Prillë 1921 Viti I, Nr. 6, fq. 3-4.*  
Diskutim mbi çeshtje ortografie. Përdorimi i ë-s tek mbiemnat femnorë (khs. i lirë). Në një shënim të gjatë Red. e kundërshton mendimin e autorit.
1152. — MIN. E ARËSIMIT BOTUER: Kryesis së Komisis letrare, Tiranë. — *KUMTARI ARSIMUER Tiranë mars 1921, Vit I, Nr. 1, fq. 3.*  
Shkresë e Min. së Arsimit mbi caktimin nga ana e Komisisë letrare të skajevet teknike (terminologjisë) për arsimin (§ 10).
1153. — MINGA, J.: Bisedë Gjuhe. — *FJAL'E LIR Vlorë 9 Prillë 1921, Viti I, Nr. 7, fq. 3; Nr. 8, fq. 3; Nr. 9, fq. 8.*  
Artikull mbi mbaresat dhe trajtat e shqueme të mbiemnavet femnorë, me krahasime me disa nga gjuhët indoeuropiane. (Artikulli botohet në lidhje me diskutimin e hapun shih Nr. 1137, 1142, 1151).
1154. — NAÇI, Profesor LEONIDHA: Lëvizja kulturele midis Shqiptarëve të Greqisë. — *SHKËNDIA (Korçë) Qershor 1921, Vit'i I (Nr. 4), fq. 61-64.*

Në këtë artikull preken këto çeshtje: 1) mbi botimin në fototipi më 1894 të disa fletëve të drsh. të fjalorthit shqip-greqisht të M. Boçarit në të përkohëshmen e Athinës *Estia*; 2) për artikullin mbi gjuhën shqipe të profesorit të Universitetit të Athinës, z. Sp. Llambros; 3) për çeljen e një shkolle shqipe në katundet Thivë-Livadhi të prefekturës së Atikës (Greqi) nga A. Kullurioti; 4) mbi gramatikën shqipe të Kupitorit; 5) mbi vajtjen në Greqi të Gjergj Pekmezit më 1895 për të studjue për së afërmi gjuhën e Shqiptarëve të Greqisë; 6) mbi botimin e Fjalorit të Kristoforidhit; 7) mbi futjen e gjuhës shqipe më 1910 në shkollën tregëtare të Korfuzit; 8) mbi votimin në parlamentin grek që mësimi i gjuhës shqipe të futet në Universitetin e Athinës dhe 9) mbi veprën «Pellazgjika» të J. Thomopullos, etj.

1155. — NIVITZA, SALIH: Nevoja e një Akademie letrare. — *HYLLI I DRITES Shkodër shtatuer 1921, Vjeta II, Nr. V, fq. 228-235.*

Artikull mbi nevojën e ngritjes së një akademie shqiptare për zgjidhjen e problemeve të ndryshme të gjuhës shqipe (hartimin e fjalorit, të gramatikës, etj.) [Artikulli asht shkruar në Stamboll me 10/23-III-1914].

1156. — PETROTTA, Dr. R.: Shqiptaret t'Italise nderojin Dimiter Kamarden Të qint viet lindjes s'tij 1821-1921. — *SHQIPERIE RE (Albania Nouë) Kostancë (Rumani) 20 nëntor 1921, Vit'i III, Nr. 55, fq. 3-4.*

Kronikë mbi kremtimin e 100 vjetorit të lindjes së Dh. Kamardës në Piana dei Greci (Siceli). Në fund botohet edhe artikulli biobibliografik me titull *Dy fjalë mbi jetën dhe veprat e Papa Dimitrit Kamardes.*

1157. — PJESA Literare. — *KOHA, Korçë 27 Gusht 1921, Vit'i XII, Nr. 58, fq. 1.*  
Vërejtje dhe ndreqje gabimesh ortografike në shkrimet e kohës.

1158. — VENDIME mâ të rëndësishme të Kongresit Arsimuer të Lushnjes të mbajtur më 15/VIII/1920. — *KUMTARI ARSIMUER Tiranë mars 1921, Vit I, Nr. 1, fq. 9-11; Nr. 2, fq. 33-35; Nr. 3-4; fq. 37-39.*

Terminologji. Botohen 220 terma të gjuhës, arithmetikës dhe gjeometrisë në gjuhët shqip e frangjisht, bisedue dhe pranue në mbledhjen e III të Kongresit Arsimuer të Lushnjes, mbajtur me 15/VIII/1920 nën kryesinë e Aleksandër Xhuvanit.

1159. — VENDIME mâ të rëndësishme të Kongresit Arsimuer të Lushnjes. — *KUMTARI ARSIMUER Tiranë Prill 1921, Vit I, Nr. 2, fq. 31; Nr. 3-4, fq. 35.*

Botohen procesverbalet e mbledhjes së VIII, IX e XIV të Kongresit Arsimuer të Lushnjes në lidhje me mungesën e një gjuhe letrare të shqipes dhe ftimin e prof. R. Nahtigal për të bashkëpunue me Komisinë letrare për themelimin e një gjuhe të përbashkët letrare e zyrtare të shqipes.

1160. — VOSHTINA, NESIP: Shkollat Kombetare në Stamboll. — *E VERTETA Stamboll (Turqi) 2 Janar 1921, Vit'I, Nr. 8, fq. 3.*

Artikull mbi funksionimin e shkollave shqipe të kolonisë shqiptare të Stambollit (shkolla e Feriqojt, me 60 nx., e Beshiqdashit, me 110 nx., e Fetahut me 30 nx., e Skutarit me 30 nx.).

1161. — XH[UVANI], A[LEKSANDER]: Selectae. — *KUMTARI ARSIMUER Tiranë maj-qershuer 1921, Viti I, Nr. 3-4, fq. 32-33.*  
Vërejtje e shënime gjuhësore mbi disa fjalë të përdorun nga J. De Rada (*gjallmari-ja, teramoni-ja, balastri-ja, bështjer-i, ubrih-u, valandi-ja, valandisem, abonsinë-a, rrëxoj*), nga F. Bardhi (*detorës, dëlirdhâmbës, dashës, përrallës, rrenës, bakeqës, grykës, gjetës, granues, shumfytyrës*) nga E. Mitko (*përgjuas, përçuas, shikuas*).
1162. — XH[UVANI], A[LEKSANDER]: Selectae. — *KUMTARI ARSIMUER Tiranë Prill 1921, Vit I, Nr. 2, fq. 28-30.*  
Kritikë Fjalorit të «Bashkimit» dhe disa neologjizmave të Papa Kristo Negovanit dhe Petro N. Luarasit.
1163. — XH[UVANI], A[LEKSANDER]: Selectae. — *SHKOLLA E RE, Shkodër Dhe-tuer 1921, Vjeti I, Nr. 12, fq. 298-300.*  
Mbi ortografinë e fjalëve: *program-i* a *programë-a?*; mbi kuptimin e disa fjalëve të dialektit të Shqiptarëve të Greqisë (*kshillonim, mendî, rusem, shkalkonj, granë-a*); mbi përdorimin e parafjalës për në fjalitë qëllimore me folje në mën. lidhore (khs. *për të shih, për të ikën, për të vejë* etj. resp. *për me pamun, për me ikun, për me vojtun*, etj.)
1164. — XH[UVANI], A[LEKSANDER]: Shumsi mbë a i emnavet mashkullorë. — *SHKOLLA E RE Shkodër marc 1921, Vjeti I, Nr. 3, fq. 43-45.*  
Artikull i mbështetun edhe në veprën e G. Majerit *Albanische Studien, I. Die Pluralbildung der albanesischen Nomina*, Wien 1883. Xhuvani kritikon përdorimin e *a-s* tek shumësi i disa emnave mashkullorë të tipit mësuesat, studentat, profesorat, etj. në vend të: mësuesit, studentët, profesorët, etj.
1165. — XH[UVANI], A[LEKSANDER]: Mbi thjeshtësinë e gjuhës. — *SHKOLLA E RE Shkodër maj 1921, Vjeti I, Nr. 5, fq. 98-100; Nr. 6, fq. 129-132; Nr. 7, fq. 154-155.*  
Artikull mbi pasunimin dhe pastërtinë e gjuhës shqipe dhe mbi kuptimin e përdorimin e idiotizmave, lokucioneve (frazelogjitë), soleqizimave, barbarizmave, neologjizmave e arkaizmave.
- 1 9 2 2 —
1166. — ANSELM Lorecchio. — *SHPRESA E ATDHEUT, Romë Prill 1922, Vjeti I, Nr. 3, fq. 83-85.*  
Shënime biobibliografike, iustrohet edhe me një fotografi të A. Lorekjos.
1167. — AVV. ANGELO Leotti. — *SHQIPERI E RE (Albania Nouë) Kostancë (Rumani) 4 Qershor 1922, Vit'i III, Nr. 82, fq. 9.*  
Shënime biobibliografike, ilustruhet edhe me një fotografi të A. Leotit. Ndër të tjera përmenden edhe këto vepra të Leotit: *Gramatikë toskënisht, fjalor gegënisht* dhe një *Fjalor shqip-italisht* (të pabotuem).
1168. — B.: Shqipja dhe Shqiptarët mbas Meyer-it. — *SHPRESA E ATDHEUT, Romë Fruer 1922, Vjeti I, Nr. 1, fq. 5-11.*

Gjuhësi krahasuese. Në këtë artikull jepet një pamje e tezavet kryesore të G. Majerit për etnogjenezën, gjenezën e gjuhës shqipe, emnin kombëtar *Shqipni* e *Albani*, disa konkordanca të shqipes me gjuhët e tjera indoeuropiane, huazimet latine në shqipet, etj.

1169. — BIBLIOGRAFI : «Vetustà della Langue Albanesc [sic] prej z. Dott. Agostino Ribecco, ff. 72. Spezzano Albanese, 1920. — *SHQIPERI E RE (Albania Noua) Kostancë (Rumani) 28 Nentor 1922, Vit'i IV, Nr. 107, fq. 5.*

Informacion bibliografik.

1170. — DI MAIO, M.: La lingua pelasga o albanese fu la vera madre del greco e del latino, secondo il parere dei dotti di quell' epoca e secondo la scoperta (!) da noi fatta sulle leggi di trasformazione [Gjuha pellasge a shqipe qe nana e vërtetë e greqishtes dhe e latinishtes simbas mendimit të të ditunve të asaj epoke e simbas zbulimit të bamë prej nesh mbi ligjë e ndryshimit]. — *AFERIMI «The Approach» New York, N.Y. (USA) Decembre 30, 1922, vol. I, Nr. 2, fq. 1; 1923, vit'i II, Nr. 3, fq. 1 (vazhdimi ndërpritet).*

Artikull.

1171. — DITUNIJA shqype e themeluesit e sajë. Nji vallim historik-letrër përmí dituni t'onë. Prehistori. — *HYLLI I DRITËS (Shkoder) Kallnduer 1922, Vjeta III, Nr. I, fq. 16-21.*

Artikull përmbledhës për etnogjenezën dhe gjenezën e gjuhës shqipe në mbështetje të rezultateve të gjuhësisë së krahasueme e përfaqësueme nga F. Bopp, Myler (Müller), Majer (Meyer), Kurtius (Curtius), Brugmann, Hirt, Schrader (Schrader).

1172. — DO LIBRA të botuem nder kto 3 vjet. — *KALENDARI I VJETËS 1922 (Vepra Pijore Nr. 29) Shkoder, fq. 78-79.*

Bibliografi për 34 botime dhe ribotime shqipe të viteve 1919-1921, ndër to për gjuhën: *Ushtrime gramatikore* për të III, IV e V klasë fillore nga A. Xhuvani, 1921; *Gramatika shqyp-latinisht*, 1921.

1173. — DRUMONT, ALBERT: L'Alphabet latin et les albanais [Alfabeti latin dhe Shqiptarët]. — *RILINDJA SHQIPETARE, Paris Qershor 1922, Viti i parë, Nr. 2, fq. 1.*

Në lidhje me një vizitë që pati rast të bante në Shqipni, Drymon, në kundërshtim me thانيت e disa të huejve, pohon faktin se Shqiptarët kanë një alfabet që i përshtatet plotësisht shqipes dhe ky asht alfabeti latin, i dëshmuem nga botimet e vjetra shqipe dhe i sanksionuem në Kongreset e Manastirit dhe të Elbasanit.

1174. — DUFOUR, Prof. LOUIS: Fjalëtore Nderkombetare. — *RILINDJA SHQIPTARE, Paris maji 1922, Viti i parë, Nr. 1, fq. 3-4; Nr. 2; fq. 3-4; Nr. 3, fq. 3-4 (vazhdimi mungon).*

Metodë për shqiptarët për mësimin e gjuhëve anglisht, frangjisht e italisht me përkthimin shqip. Në fund jepet një fjalorth në katër gjuhë (anglisht, frangjisht, shqip e italisht) i pajisun edhe me ilustrime (figura).

1175. — DUFOUR, Prof. LOUIS: Historija e alfabetit që në kohërat më të vjetra gjër në kohën e sotme. Ca zbulime të reja mbi gjuhën shqipë. — *ATDHEU (Vlonë) 28 Prill 1922, Vit'i I, Nr. 6, fq. 163-170.*

Artikull mbi alfabetet e lashtë (piktografike, hieroglifike, ideografike, etj.) të popujve të ndryshëm, ilustrue me pasqyra. Jepet një pjesë e lutjes fetare «Ati i ynë» në 13 gjuhë të Europës, Azisë e Afrikës. Në lidhje me shënimin *Ca zbulime të reja mbi gjuhën shqipe*, autori sjell 75 fjalë me shembuj nga gjuha kurde, të cilat, Dyfur, tue u nisë nga ngjajshmëria e jashtëme, i krahason me shqipen.

1176. — DUFOUR, Prof. LOUIS: *Letrë e hapëtë. Përgënjeshttrim mbi sa boton Z.N. Lako kundra meje ndë №102 të së vleftëshmes gazetë «Shqiperi e Re».* — *SHQIPERI E RE (Albania Nouë) Kostance (Rumani) 28 Nentor 1922, Vit'i IV, Nr. 107, fq. 3.*  
Përgjigje kritikës së N. Lakos (shih Nr. 1182). Autori këtu jep edhe disa të dhana të jetëshkrimit të vet.
1177. — GIUKA, SALI: *Bisedim gjuhe: Mbi Parashtojen «Bashk».* — *ATDHEU (Vlonë) 28 Shkurt 1922, Vit'i I, Nr. 4, fq. 122-125.*  
Mbi kuptimin dhe përdorimin e parashtesës *bashk-* që i përgjigjet fjalëve *hem-*, *sin-*, *kon-* (resp. persisht, greqisht dhe latinisht). Formimet *bashkëzanore*, *bashkpunim* etj. simbas autorit janë të parregullta. Artikulli vijon edhe mbi disa çeshtje të fjalëformimit.
1178. — GJEÇOV, A.SH.K.: *Sebaste n'Armeni apo n'Arbëni? ...* Shih Nr. 1139 (1921).
1179. — GURAKUQI, GASPER: *Sapa.* — *HYLLI I DRITËS (Shkodër) nanduer 1922, Vjeta III, Nr. XI, fq. 519-527.*  
Përmban edhe të dhana për toponomastikën e Sapës me shënime e vërejtje etimologjike të autorit.
1180. — GURAKUQI, KARL: *Harti i shkrimit e historia e tij.* — *ATDHEU (Vlonë) 31 Kallënduer 1922, Vit'i I, Nr. 3, fq. 71-73.*  
Artikull mbi historinë e formimit të alfabeve të hershme të njerzimit, mbështetë edhe në veprën e Uiljam (William) A. Mason «Historija e hartit të shkrimit». Në këtë artikull flitet edhe për origjinën e alfabetit latin, i cili u adoptue edhe prej shqipes.
1181. — HARITO, THEODORE: *Gjuha shqipe ne rezik prej gazetareve të saj. Shkrimtaret qe përdorin fjale te huaja i bejne dem kombesisë, mesoni shqipen e vertete. Kur do pushoje dituri e reme?* — *THE ALBANIAN JOURNAL (Xhurnalli Politik) Chicago, U.S. America, February 5, 1922, Vol. II, Nr. 3, serial Nr. 15, fq. 1-2.*  
Kritikë gazetës *Shqiperi e Re* të Kostancës (Rumani) për përdorim fjalësh të hueja.
1182. — LAKO, N.: «*Rilindja Shqipëtare*» dhe direktor'i saj «profesor» Louis Dufour. — *SHQIPERI E RE (Albania Nouë) Kostancë (Rumani) 22 Tetor 1922, Vit'i IV, Nr. 102, fq. 2.*  
Kritikë. Përmban edhe disa shënime për jetëshkrimin e L. Dyfur (shih edhe Nr. 1176).
1183. — LUMO SKENDO (Pseud. i *Mid'hat Frashërit*): *Duke kenduar një libër.* — *HYLLI I DRITËS (Shkodër) Kallnduer 1922, Vjeta III, Nr. I, fq. 34-37.*  
Recension vëllimit «*Histori e Shqipëtarvet t'Italisë*» prej Petro Scaglione, New-York, 1921 fq. 101.

1184. — M[ARLASKAJ], P. A[MBROS]: Mbi ortografi të soteshme... Shih Nr. 1150 (1921).
1185. — MSUESI (Pseudonim): Gjuhë e shtypit gjuhë e popullit. — *DITË RE Tiranë* 20 Korrik 1922, Vit'i I, Nr. 21, fq. 1.  
 Artikull mbi kujdesin e pakët që po tregohet në shtyp për pastërtinë e gjuhës shqipe nga fjalët e hueja.
1186. — QARKORE. — *DITË RE Tiranë* 31 maj 1922, Viti I, Nr. 10, fq. 4.  
 Qarkore e Ministrisë së Arësimit mbi përgatitjen e një kongresi arsimuer. Në këtë kongres do të diskutohet edhe çështja e mbledhjes së visarit të gjuhës nga ana e arsimtarëve si dhe programi i punës për hartimin e një fjalori të gjuhës shqipe.
1187. — QUFLQUES Albanais illustres [Disa Shqiptarë të shquem]. — *RILINDJA SHQIPTARE Paris Qershor 1922, Viti i parë, Nr. 2, fq. 2-3.*  
 Onomastikë. Të dhana të shkurta mbi disa nga pinjujt e tri familjeve shqiptare *Albani, Kupruli e Gjika*, nga të cilët duelen respektivisht një papë (Klementi i XI), një Vizir i madh (Muhamed Kupruli) dhe Helena Gjika (Dora D'Istria).
1188. — QYTEZA, SABRI: Shkollat shqipe në Stamboll. — *SHQIPERI E RE (Albania Nouë) Kostancë (Rumani) 9 Korrik 1922, Vit'i IV, Nr. 87, fq. 2.*  
 Korrespondencë mbi mbarëvajtjen e shkollave shqipe «Shqiponja», «Naim Frashëri» dhe «Kosova» të Stambollit. (Po në këtë gazetë në Nr. 54, fq. 1 jepet fotografia e nxanësve të shkollës «Kosova» e vjetit 1920; në Nr. 79, fq. 1 fotografia e nxanësve të shkollës «Shqiponja», në Nr. 82, fq. 1, fotografia e nxanësve dhe e nxanëve shqiptarë të shkollës shqipe të Stambollit).
1189. — RIBECCO, Dott. A.: Vetustà della lingua albanese e sua importanza nella spiega del Mondo Antico. Vocaboli di uso mondiale [Lashtësia e gjuhës shqipe dhe randësia e saj në spjegimin e Botës së Vjetër. Fjalë me përdorim të përbotshëm]. — *RILINDJA SHQIPTARE Paris maji 1922, Viti i parë, Nr. 1, fq. 1; Nr. 2, fq. 2; Nr. 3, fq. 1; Nr. 4, fq. 3 (vazhdimi mungon).*  
 Fjalorth etimologjik. Ribotim, shih edhe Nr. 1050.
1190. — SHKOLLAT Shqiptare të Stambollit. — *DRITA Gjinokastrë* 2 Korrik 1922, Vit'i III, Nr. 105, fq. 3.  
 Botohet një letër e Nesip Era, mësues i shkollës shqipe «Shqyponja» të Stambollit, mbi gjendjen e pesë shkollave shqiptare të Stambollit.
1191. — SINA, ATHANAS: Mendime mbi gjuhënë t'ënë. — *PERLINDJA ARESIM-TARE Korçë* 15 Qershor 1922, Vit'i I, Nr. 1, fq. 4-10.  
 Artikull mbi mungesat dhe të metat e teksteve gjuhësore shqipe (gramatika etj.) dhe mbi nevojën e një gjuhe të përbashkët të shqipes.
1192. — SIRDANI, P. MARIN: Shqyptarët e hartet. IV Shkrimi. — *HYLLI I DRITËS (Shkodër) Prill 1922, Vjeta III, Nr. IV, fq. 178-186.*  
 Shënime për historinë e alfabeve dhe të shkrimit sqqip.

1193. — VULLKAN, PETRO: Fisi i Shqiptarëve. Çdo-me-thënë Shqipëtar? — *DO-DONA, Constanta—Romania, Janar 1922, Vit'i I-rë, №1, fq. 6-9*

Në lidhje me origjinën e emnit *Alban* dhe lokalizimin e vendit Albanopolis, autori shkurtimisht radhitë thaniet e Cn. Ptolomacus, Carolus Mülerius, Jausz Geörgy, Henrish Kiepert, Fallmerayer, Dr. Marinesku, Teodor Mommsen, Heusberg, Frantz Miklosich, Rudinsky e G. Majer. Fjala *Albania*, vijon autori, shpjegohet me ndihmën e keltishtes: *Al* (i math, i lartër) *ban* (mal) *us* (njeri ndenjës). *Albanus* do të thotë ndenjës mali të lartë. Fjala *Shqipëtar*, simbas W. Obermüller, rrjedh nga *qeab*, *qeap*, *qip* që do të thotë *maje bregu*, *maje mali*, *shkëmb*, kësaj i shtohet një *s* përpara, e cila jep *sqip* nga e cila u formue fjala *shqip*, *shqiptar*.

— 1923 —

1194. — BIBLIOGRAFI. — *HYLLI I DRITËS (Shkodër) Kallnduer 1923, Vjeta IV, Nr. I, fq. 48; Nr. VIII, fq. 384; Nr. X, fq. 480; Nr. XII, fq. 568.*

Informacione dhe shënime bibliografike. Për gjuhën edhe:

Nr. I, 1) *Libri i gjuhës shqipe*, pjesë e dytë për klasën e IV të Shkollës Fillore, prej A. Xhuvanit.

2) *Njehunit (sic) e para të Syndaksës Shqipe*, Pjesë e parë për Klasët e Nalta të Fillores, prej A. Xhuvanit, Vlorë Shtypshkroja «Vlora», 1922.

Nr. VIII 1) *Linguistisch-Kulturhistorische Untersuchungen aus dem Bereiche des Albanischen*, von Norbert Jockel, Berlin und Leipzig, 1923. V

Nr. X 1) *Grammatikë e gjuhës shqype* prej Koço Tasit — Vlonë, Shtypshkronja «Vlora» G. Direttore, 1923.

Nr. XII 1) *Ditunija gjuhore indogjermane* prej Hofrat Dr. Paul Kretschmer, përkthyer prej Karl Gurakuqit, Tiranë, shtyp. «Nikaj», 1923.

1195. — BIBLIOGRAFI: *Ilirët e Hofratit Dr. Karl Patsch-it Profesor n'Universitet te Vjenës. — SHTYPI, Tiranë 2 Tetuer 1923, Vjeti I Nr. 47, fq. 4.*

Recension i blenit të parë, botim i Min. s'Arësimit, përkth. shqip nga K. Gurakuqi.

1196. — BIBLIOGRAFI: *Ditunija Gjuhore indogjermane* prej Prof. Hofrat Dr. Paul Kretschmer, përkthyer në gjuhën shqipe prej Prof. Karl Gurakuqit. Libri ka 77 faqe dhe është shtypur në shtyp. «Nikaj» Tiranë. — *SHQIPERI E RE, (Albania Nouë) Kostancë (Rumani) 30 Dhjetor 1923, Vit'i V, Nr. 160, fq. 4.*

Shënime bibliografike me një recension të shkurtën.

1197. — BIOGRAFI e shkurtër e z. Faik Konitza. — *SHQIPETARI I AMERIKËS, Korçë 21 Korrik 1923, Vol. I, Viti I, Nr. 40, fq. 1.*

Ilustrohet edhe me një fotografi të F.K.

1198. — BISEDIM gjuhe mbi orthografië. — *MBROJTJA KOMBËTARE Vlorë 22 mars 1923, Vit'i IV, Nr. 9, fq. 2-3 (vazhdimi ndërpritet).*

Artikull mbi përdorimin e shkronjës ë.

1199. — BRANDEJS, Dr. STANISLLAV: Mi të parin albanollog çek zotin profesor Jan Urban Jarnik. — *ZËRI I POPULLIT Korçë 23 Maj 1923, Vit'i I. № 44, fq. 3.*  
 Artikull biobibliografik, shkruar me rastin e dymujorit të vdekjes së J.U. Jarnik. Jarniku, thuhet në këtë artikull, shkroi edhe këto vepra për gjuhën shqipe: «*Studime mi gjuhën shqipe*» 1881 (e para vepër e Jarnikut për shqipen), e cila më 1883 u plotësua me veprën: «*Studime për të njojtur dialektet shqiptare*» etj. shkruar në çekisht. Veç këtyne flitet edhe për një tok shkrimesh të tjera: kritika, korrespondenca e studime të ndryshme që i përkasin gjuhës shqipe.
1200. — CHEKREZI, C.A.: Letre e hapur Faik Konitzes — *SHKENDIJA, Watertown Mass. (USA) July 7 (1923) vol. II, Nr. 2, fq. 1-2.*  
 Përgjigje F. Konicës lidhur me kritikën e këtij të fundit ba fjalorit të K. Çekrezit (shih Nr. 1213).
1201. — DI MAIO, M.: La lingua pelasga o albanese fu la vera madre del greco e del latino... Shih Nr. 1170 (1922).
1202. — FJALORI inglisht-shqip u-vu ne shtyp. — *DIELLI Boston, Mass. (USA) march 7, 1923, 15th Year, Vol. XV, Nr. 2563 (106), fq. 7; Nr. 2566 (109), fq. 7; Nr. 2573 (116), fq. 8.*  
 Njoftim mbi botimin e fjalorit inglisht-shqip (prej 25.000 fjalësh) hartue nga Kost Çekrezi. Fjalori përmban edhe një parathanie nga F. Konica.
1203. — FJALORI inglisht-shqip u-vu ne shtyp. — *AFËRIMI «The Approach» New York, N.Y. March 24, 1923, Vit'i II, Nr. 5, fq. 3.*  
 Mbi fjalorin e Kost Çekrezit (shih edhe Nr. 1202).
1204. — FRASHERI, STAVRE, Th.: Nermjesfjalim per mirësimin e gjuhes. — *SHQIPERI E RE (Albania Nouë) Konstancë (Rumani) 4 Shkurt 1923, Vit'i IV, Nr. 116, fq. 3-4; Nr. 117, fq. 3-4; Nr. 118, fq. 3-4.*  
 Mbi zavendësimin e fjalëve të hueja *subjekt, impresion, koincidon*, etj. me kalket *nënëqenie, nënshtypje, bashkëbie*, etj. (Shkrimi paraqitet në trajtë dialogu).
1205. — GJERGU, LLAMBI: Jerolam De Rada. — *DRITA, Gjinokastrë 22 Shkurt 1923, Vit'i III, Nr. 124, fq. 2-4; Nr. 125, fq. 2-3; Nr. 127, fq. 2-3.*  
 Artikull biobibliografik. Per një numër veprash të De Radës, autori jep të dhana mbi përmbajtjen e tyre dhe komente.
1206. — GJUHA Zyrtare. — *DRITA Gjinokastre 2 mars 1923, Vit'i III, Nr. 125, fq. 1.*  
 Kritikë vendimit të qeverisë në lidhje me caktimin e dialektit të Elbasanit si bazë e gjuhës zyrtare të shtetit (shih Nr. 1214).
1207. — GJUHA Zyrtare. — *DIELLI Boston, Mass. (USA) Aprill 11, 1923, 15th Year, Vol. XV, Nr. 2573 (116), fq. 5*  
 Shih Nr. 1206.
1208. — GRAMATIKA prej Koço Tasit. — *SHQIPETARI I AMERIKËS Korçë 8 Shtator 1923, vol. I, Viti I, Nr. 47, fq. 6.*  
 Informacion bibliografik.

1209. — INFORMAZIONI: Per un'altra Cattedra di lingua e letteratura albanese da istituirsì in Italia [Informata: Për një tjetër katedër të gjuhës dhe të letërsisë shqipe për t'u ngritun në Itali]. — *LA NAZIONE ALBANESE Pallagorio (Catanzaro) Italia, 15 Febbraio 1923, Anno XXVII, Nr. 3, fq. 5-6.*

Botohet një ekstrakt i procesverbalit të asamblesë së II të përgjithëshme të Institutit për Europën Lindore (Istituto per l'Europa Orientale), mbajtur në Romë me 28 janar 1923, në lidhje me propozimet dhe kundërpropozimet për çeljen e një katedre të gjuhës dhe të letërsisë shqipe në Universitetin e Romës.

1210. — IRIS\*) (Pseud. i Justin Rrotës): Rreth gramatologjis shqype. — *HYLLI I DRITËS (Shkodër) Ndanduer 1923, Vjeta e IV, Nr. XI, fq. 516-522; — 1924, Vjeta e V, Nr. 11, fq. 467-473; — 1931, Vjeta e VII, Nr. 11, fq. 616-620; — 1932, Vjeta VIII, Nr. 12, fq. 611-616; — 1933, Vjeta IX, Nr. 7-8, fq. 315-321.*

Studim. Mendime dhe vërejtje rreth hartimit të gramatikes nga burimi gojor i popullit; shënime kritike për çeshtje të ndryshme të morfologjisë dhe sintaksës; vërejtje dhe shënime mbi foljet (paskajoren, pjesoren dhe emnat foljorë), trajtat foljore, fonemat dhe ortografia e verbit substantiv.

1211. — KOLONIA, PETER, V.: Program i shkollës së verës në Worcester, Mass. — *KOMBI NE REZIK Boston, Mass. (USA) June 23, 1923, Vol. I, Nr. 6, fq. 7.*

Njoftime mbi programin dhe funksionimin e një shkolle shqipe për shqiptaret e Worcesterit (SHBA).

1212. — KONITZA, FAIK: Një mesim i vogël në dituri të gjuheve. — *DIELLI Boston, Mass. (USA) April 14, 1923, 15 Year, Vol. XV, Nr. 2576, fq. 2.*

Artikull didaktik. Veçanërisht citohet vepra *Grundriss der romanischen Philologie*, botue më 1888, nën kryesinë e prof. Groeber, në të cilën Gustav Majer i kushtoi një studim të gjatë elementit latin në gjuhën shqipe, plotësue në botimin e dytë nga Majer-Lybke (Meyer-Lübke).

1213. — KONITZA, FAIK: «Fjalori» inglisht shqip i Çekrezit. — *KOMBI NE REZIK Boston, Mass. (USA) June 23, 1923, vol. I, Nr. 6, fq. 5; Nr. 7, fq. 5; Nr. 16, fq. 5.*

Në kundërshtim me parathanien e shkrueme në Fjalorin anglisht-shqip të Çekrezit (shih Nr. 1202), autori në të tre artikujt e sipërm mban qendrim kritik të ashpër ndaj fjalorit të Çekrezit.

1214. — MBI djalektin zyrtar. — *FLETORJA ZYRTARE Tiranë 21 Kallnduer 1923 Vjeti II, Nr. 3, fq. 1.*

Komunikohet urdhëni i Kryeministrisë Nr. 148, dt. 13.I.1923 me anën e të cilit autorizohen të gjitha zyrtat e shtetit që të përdorin në aktet zyrtare dialektin e Elbasanit. (*Qarkore e Min. së P. Mbrendëshme drejtue gjithë Prefekturavet*)

\*) Dy artikujt e parë u botuen pa nënshkrim, nga artikulli i tretë nënshkruhen me pseudonimin Iris (Sh. i A.)

1215. — MEYER, GUSTAVO: Della lingua e della letteratura albanese [Nga gjuha dhe nga letërsia shqipe]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia 15 marzo 1923, Anno XXVII, Nr. 5, fq. 4.*  
 Artikull mbi J. De Raden (ekstrakt marrë nga *Nuova Antologia*, vol. I, Seria II, 15 Aprile 1885).
1216. — NJË RIVISTË e re në Beligrad mbi Kombin Shqipëtar. — *ZËRI I POPULLIT Korçë 21 Nëntor 1923, Viti I-rë, Nr. 73, fq. 1.*  
 Kronikë mbi fillimin e botimit të së përkohëshmes së Universitetit të Beogradit «*Arhiv për Antikën Shqipëtare, Gjuhën dhe Etnologjinë*» (Arhiv za arbanasku starinu, jeziku i etnologiju), e drejtuar nga H. Bariç me oponent [!] T.P. Georgeviç.
1217. — NJI PROPOZIM Ministries se Arsimit. — *RRUFEJA Tiranë 9 mars 1923 Viti I, Nr. 1, fq. 1-2.*  
 Kritikohet qeveria për interesimin e pakët që po tregon ndaj problemeve të gjuhës shqipe.
1218. — NJË NËPUNËS (Pseud. i *Karl Gurakuqit*): Gjuha zyrtare. — *SHTYPI Tiranë 21 Prill 1923, Vjeti I, Nr. 27, fq. 1.*  
 Artikulli i kushtohet zbatimit të vendimit të qeverisë (Shih Nr. 1214) lidhur me caktimin e të folmes së Elbasanit si bazë e gjuhës zyrtare të shtetit.
1219. — PATSCH, Prof. Dr. KARL: Muzeu Komtar në Tiranë. — *KRYQI I KUQ-SHQIPTAR Tiranë maj 1923, Vjeti i I-rë, Nr. 9, fq. 198-200; Nr. 10, fq. 225-226 (vazhdimi mungon).*  
 Preken edhe çeshtje të etnogjenezes (Shqiptarët si mbasardhës të iliro-trakëve), prejardhja trake e disa emna vendesh si Shkodra, Leshi, etj. (Përkth. nga Karl Gurakuqi).
1220. — PEMMA, NIK: Urban Jarnic vdiq. — *SHQIPERI E RE (Albania Noua) Kostancë (Rumani) 25 shkurt 1923, Vit'i IV, Nr. 119, fq. 1.*  
 Nekrologji për albanologun e Pragës.
1221. — PER DIALEKTIN Zyrtar. — *SHQIPETARI I AMERIKES Korçë 10 Shkurt 1923, Vit'i I, Vol. I, Nr. 27, fq. 4.*  
 Artikull i Red. kundër vendimit të qeverisë (shih nr. 1214) në lidhje me caktimin e të folmes së Elbasanit si bazë e gjuhës zyrtare të shqipes.
1222. — SEINER, FRANC: Numrimi i parë i popullsis në Shqypni. — *HYLLI I DRITES (Shkoder) Kallnduer 1923, Vjeta e IV, Nr. 1, fq. 17-22; Nr. II, fq. 65-70.*  
 Përmban edhe toponime.
1223. — XH[UVANI], A[LEKSANDER]: Dhialekti i Elbasanit. — *ELBASANI, Elbasan 29 Kall(n)duer 1923, Viti I, Nr. 7, fq. 1.*  
 Artikull pro vendimit të qeverisë (shih Nr. 1214) në lidhje me caktimin e të folmes së Elbasanit si bazë e gjuhës zyrtare të shqipes.
1224. — XHUVANI, A.: Kristoforidhi n'Endërrë. — *SHQIPTARI I AMERIKES Korçë 25 gusht 1923, Viti I, Vol. I, Nr. 45, fq. 4-5; Nr. 46, fq. 5-6; Nr. 48, fq. 6; Nr. 49, fq. 6-7.*

Përmes një dialogu letrar të trilluem Kristoforidhi-Xhuvani, autori çfaq pikëpamjet e veta lidhun me një varg çeshtjesh të zhvillimit të gjuhësisë dhe letërsisë shqipe (vlerësime, kritika, etj.). Xhuvani sqaron edhe mjaft pika të jetëshkrimit të Kristoforidhit (lidhun edhe me monografinë «Jetëshkrimi i Kostandin Kristoforidhit» prej S. Shuteriqit, Monastir Shtyp. Tregetare Nerkombetare, 1911) si dhe të jetëshkrimit të vet.

— 1924 —

1225. — BIBLIOGRAFI: «*Ditunia gjuhnore Indogjermane*» prej Dr. Karl Kretschmer, profesuer i rregullshem e botuer n'Universitetin e Vjenës, përkthye prej Z. Karl Gurakuqit. — *DRITA Gjinokastre 6 Janar 1924, Viti V, Nr. 153, fq. 3.*  
Shënime bibliografike.
1226. — BIBLIOGRAFI. — *E DREJTA Korçë 2 Prill 1924, Per. II, Vit'i I, Nr. 30, fq. 3.*  
Shënime bibliografike për vëll. e I, Pj. 1 e 2 të së përkohëshmes *L'Archiv*, etj. që botohet në Beograd nën drejtimin e Prof. H. Bariç.
1227. — BIBLIOGRAFI: «*Iashtëvënie te mënyrës për të traituar fialët e rea*» pre Pikës, fq. 132, Shtypur në Bukuresht. — *DRITA Gjinokastrë 26 maj 1924, Viti V, Nr. 171, fq. 1.*  
Shënime bibliografiko-kritike.
1228. — [BIBLIOGRAFI]: «*Iashtevenie te menyrës për te traituar fialet e rea*» nga Pika. — *SHQIPERI E RE (Albania Nouë) Konstance (Rumani) 16 Nentor 1924, Viti VI, Nr. 199, fq. 4.*  
Shënime kritike (marrë nga gaz. *Bashkimi*, shih Nr. 1244).
1229. — GAZULLI, N.: Gjurmime mî vepren e D. G. Buzukut. — *HYLLI I DRITES Shkoder Tetuer 1924, Vjeta e V, Nr. 10, fq. 433-436.*  
Shënime rreth gjurmimeve të autorit në lidhje me vepren e Buzukut.
1230. — GJEÇOV, A.S.K.: Trashigime Thrako-ilirjane: Bét, besimet e do doke tjera mes cillash dishmohet vjetersija e kombit Shqiptar. — *HYLLI I DRITES Shkoder Kallnduer-Fruer 1924, Vjeta e V, Nr. 1-2; fq. 54-59; Nr. 3-4, fq. 121-127; Nr. 9, fq. 356-359; Nr. 11, fq. 500-504; Nr. 12, fq. 552-553.*  
Të dhana për etnogjenezën, etimologjinë dhe toponomastikën shqiptare (Ky punim nisi të botohet pjesërisht edhe në: shih Nr. 1096).
1231. — GJUKA, [SALI], *Bisedim gjuhe: Mbi gjinië të prapashtojës sme.* — *DAJTI Tiranë 24 Shtatuer 1924, Vjeti i I-rë, Nr. 47, fq. 2-3.*  
Diskutim rreth gjinisë së fjalëve me mbrapashtesën *-ismë* a *-izmë* (khs. muhamedanizmë, helenizmë, etj.). Në analogji me fjalë të tipit *pazmë, parzmë, darsmë*, etj. autori pohon se të gjitha fjalët që formohen me ndihmën e kësaj mbrapashtese marrin gjininë femnore.
1232. — GJUKA, [SALI]: Përgjegje «*Thumbit Letrar*» në Fletoren «*Bashkimi*». — *DAJTI Tiranë 10 Tetor 1924, Viti i I-rë, Nr. 49, fq. 4; Nr. 52, fq. 2.*  
Polemikë rreth prejardhjes së mbrapashtesës *-zmë* (Shih edhe Nr. 1234, 1243, 1245.).

1233. — HISTORI E fisëve të Shqipnis éper (mbas kallximesh vendit, Prej K. *Mirakaj*, mësuës n'iballe). — *AFRIMI (Permet) Kallnduër-Shkurt 1924, Vjeti II, Nr. 1-2, fq. 228-235 (vazhdimi ndërpritet)*.  
Përmban edhe onomastikë.
1234. — HOSTENI LETRAR (Pseudonim): Margaritarët e Shtypit Kombëtar. — *BASHKIMI Tiranë 14 Tetuer 1924, Viti I, Nr. 19, fq. 2*.  
Polemikë me S. Gjukën rreth prejardhjes dhe gjinisë së emnavet të formuem me mbrapashtesën *-ismë* a *-izmë* (Shih edhe Nr. 1231, 1232, 1243, 1245).
1235. — IRIS (Pseud. i *Justin Rrotës*): Rreth gramatologjis shqype... Shih Nr. 1210 (1923).
1236. — KAKARRIQI, PIETER: Gjuha zyrtare e Shtetit Shqiptar. — *DIELLI Boston, Mass. (USA) January 29, 1924, 16th Year, Vol. XVI, Nr. 2670 (213), fq. 2*.  
Artikull mbi nevojën e pastrimit të gjuhës shqipe nga fjalët e hueja dhe krijimin e një gjuhe zyrtare të shqipes.
1237. — MESIME shqip në sallen të Komitetit. — *PAQJA Stamboll 14 Shkurt 1924, Viti I, Nr. 13, fq. 1*.  
Njoftime mbi mësimin e gjuhës shqipe në Koloninë shqiptare të Stambollit, nën drejtimin e Asaf Xhaxhulit.
1238. — NOTA, SEZAI; Hieronim De Rada. — *POLITIKA Vlorë 6 Nândori 1924, Viti III, Nr. 33, fq. 3*.  
Shënime biobibliografike. Në fund thuhet se trashigimtari i Jeronim De Radës, Zef De Rada, i dhuroi Shtetit shqiptar gjithë veprat e botueme dhe dorëshkrimet e ungjit të vet. Jepet edhe një shënim i Red.
1239. — PEKMEZI, Dr. GJERQ: Jetëshkrimi i ... — *KOHA Korçë 6 shtator 1924, Vit'i XVI, Nr. 192, fq. 1*.  
Autobiografi.
1240. — PLAKU (Pseudonim): Emëra fshati a qyteti për emëra shtëpie. — *SHQIPERI E RE (Albania Nouë) Konstancë (Rumani) 23 mars 1924, Vit'i V, Nr. 171, fq. 4*.  
Autori kritikon përdorimin e emnavet të qyteteve a të katundeve për llagape (sjell si shembull përdorimin e llagapit *Frashëri*)
1241. — PORADECI, LASGUSH: Çeshtja e fjalëve të reja në gjuhën shqipe. — *SHQIPERI E RE (Albania Nouë) Konstancë (Rumani) 28 Nentor 1924, Vit'i VI, Nr. 200-201, fq. 4 (vazhdimi ndërpritet)*.  
Kritikë librit të Pikës «Iashtevenie të Menyrës për të traituar fiolet e rea», fq. 132, Bukuresht 1924.
1242. — SHKABA, N.: Nevoja për gjuhen shqipe. — *SHQIPERI E RE (Albania Nouë) Konstancë (Rumani) 27 Prill 1924, Vit'i V, Nr. 176, fq. 2*.  
Kritikë kundër përdorimit të fjalëve të hueja dhe prishjes së gjuhës në shtyp nga njerëz që fshihen mbrapa pseudonimeve. Autori thekson që të përdoren fjalët e dialekteve të ndryshme në vend të fjalëve të hueja.

1243. — THUMBI LETRAR (Pseudonim): Si asasinohet gjuha shqipe (sic). — *BASHKIMI Tirane 26 Shtatuer 1924, Viti I, Nr. 14, fq. 4.*  
Kritikë artikullit të S. Gjukës (Shih Nr. 1231) mbi mbrapashtesën -ismë a -izmë dhe mbi kuptimin e disa emnave kolektivë.
1244. — THUMBI LETRAR (Pseudonim): Margaritarët e Literatyrës Kombëtare. — *BASHKIMI Tiranë 17 Tetuer 1924, iVti i I, Nr. 20, fq. 3.*  
Kritikë vëllimit «Iashtevenie te menyres për te traituar fialet e rea» nga Pika.
1245. — THUMBI LETRAR (Pseudonim): Margaritarët e Shtypit Kombëtar. — *BASHKIMI Tiranë 17 Tetuer 1924, Viti i I, Nr. 20, fq. 3.*  
Polemikë me S. Gjukën (Shih Nr. 1231, 1232, 1234, 1243,) mbi mbrapashtesën -smë a -zmë.
1246. — XHER-XHEMI (Pseudonim): Bigllosia. — *TIRANA Tiranë 18 Maj 1924, Viti A, Nr. 4, fq. 1.*  
Artikullshkruesi mendon se gjuha shqipe asht e vorfën dhe se pasunimi i saj duhet ba me ndihmën e fjalëve të hueja.
1247. — XH[UVANI], A[LEKSANDER]: Usus norma loquendi [Regulli i perdorimit të të folunit]. — *BASHKIMI Tiranë 30 Tetuer 1924, Viti i I, Nr. 24, fq. 3.*  
Artikull per pastërtinë e gjuhës shqipe nga fjalët dhe shprehjet (konstruktet) e gabueme, të ndertueme kundër natyrës së gjuhës shqipe, të cilat ndeshen dendun në gjuhën e shkrueme e te folun. Autori kritikon edhe mjaft neologjizma të P.N. Luarasit, Papa K. Negovanit e T. Mios. Së fundi prek shkurt edhe diftongun e shqipes dhe ambigjeninë.
1248. — XY (Pseudonim): Shêj pabashkimit a shêj pasunije giûhe?. — *KALENDARI I VJETES 1924 (Vepra Pijore Nr. 33) Shkoder, fq. 84-85.*  
Vërejtje mbi lëkundjet ortografike në gjuhën shqipe. Autori shkruen se në botimet e këtyne njëzet vjetëve të fundit vihen re lëkundje të shumta në fushën e ortografisë së fjalëve të të dy dialekteve të shqipes (khs. geg.: *tu, tue, tuë, tuj, tuej, tuëj, tujë* dhe tosk.: *tuke, ture, tye, tyke, duk, duke, dyke* etj.)
- 1 9 2 5 —
1249. — FRASHERI, MEHDI: Nja dy fjale për arsimin e Shqipniës. — *DAJTI Tiranë 10 korrik 1925, Viti II, Nr. 85, fq. 1-2; (Nr. 86 mungon); Nr. 93, fq. 1; Nr. 94, fq. 1; Nr. 95, fq. 1 (vazhdimi nderpritet).*  
Ne Nr. 93 autori trajton shkurtazi edhe problemin e gjuhes letrare të shqipes si dhe nevojën për vepra gjuhësore shqipe (fjalorë, gramatika, etj).
1250. — G[URAKUQI], K[ARL]: 30 Vjetori i vdekjes së Kostantin Kristoforidhit. — *REVISTA PEDAGOGJIKE Tiranë korrik-gusht 1925, Vjeti III, Nr. 7-8 fq. 252-255.*  
Artikull përkujtitor biobliografik.
1251. — «GRAMATIKE Shqip-Frengjisht». — *ZËRI I KORÇËS Korçë 29 Gusht 192: Viti I, Nr. 13, fq. 3.*  
Informacion bibliografik me shënime (Përsëritet në disa numra).

1252. -- «GRAMATIKE e Gjuhës Shqip» prej K. Ikonomit. — *ZËRI I KORÇËS Korçë* 29 Shtator 1925, Viti I, Nr. 22, fq. 2.  
Informacion bibliografik me shënime (Persëritet në disa numra).
1253. — IREÇEK, [sic] Dr. K.: Shqypnija e mesme në kohët e vjetra. — *REPUBLIKA Shkoder 1 marc 1925, Vieta III, Nr. 5, fq. 4; Nr. 6-7, fq. 3; Nr. 8, fq. 3; Nr. 9, fq. 3; Nr. 10, fq. 2-3; Nr. 11, fq. 2; Nr. 13, fq. 3.*  
Studim. Përmban edhe të dhana e shënime për toponomastikën historike.
1254. — KRAHI I RRMAKTË (Pseud.: i Anton Mazrrekut): Shkollat dhe gjuha jonë. — *ZANI I POPULLIT Shkoder 18 Korrik 1925, Vjeta I, Nr. 13, fq. 1-2.*  
Shkruen edhe mbi nevojën e pastërtisë së gjuhës shqipe nga fjalët e hueja të panevojshme, që qarkullojnë në shtypin e kohës.
1255. — LOGORECI, M.: Çudi gjuhe. — *REVISTA PEDAGOGJIKE Tiranë Maj-Qershuer 1925, Vjeti III, Nr. 5-6, fq. 189-192.*  
Mbi kuptimin e emnave herë e botë, prejardhja mitologjike e tyre dhe formimi i sinonimeve ndajfoljore atëherë e atëbotë.
1256. — LOGORECI, M.: Gjuha. — *REVISTA PEDAGOGJIKE Tiranë Shtatuer-Tetuer 1925, Vjeti III, Nr. 9-10, fq. 282-289.*  
Artikull mbi nevojën e mbledhjes së visarit të popullit për pasunimin e leksikut të shqipes.
1257. — PANARITI, QERIM: Evolucia e gjuhes shqip edhe leronjesit e saj. — *IMMIGRANTI (The Immigrant) Worcester, Mass. (USA) 3 Tetor 1925, Viti I, Vol. I, Nr. 2, fq. 4; Nr. 3, fq. 4; Nr. 4, fq. 3-4.*  
Artikull kronologjik për historinë e shkrimit shqip (nis me veprën e P. Budit *Speculum Confessionis* 1621 dhe vijon deri tek disa autorë bashkëkohas). Në fund jep edhe disa shënime për dijetarë dhe vepra të hueja që iu kushtuene studimit të gjuhës shqipe.
1258. — PËRMI Nalt-shkrimin edhe përmbi vjershërimin shqip. — *ZANI I NALTË Tiranë Prill 1925, Vit'i II, Nr. 2, fq. 433-438; Nr. 3, fq. 473-478.*  
Këshilla një lexuesi mbi mënyrën e përdorimit të fjalëve dhe frazave në gjuhën shqipe. Simbas autorit në vend të fjalëve *zavendës, bamirës, dashamirës*, etj. duhet të përdoren fjalët *vëntzënës, mirëbanës — mirëbënjës, mirëdashës*, etj. Në këtë artikull autori krijon edhe një numër neologjizmesh.
1259. — TIEL (Pseudonim): Salih Gjuka. — *AFRIMI (Vlone) 28 nanduer 1925, Vjeti I, Nr. 5, fq. 2.*  
Nekrologji.
1260. — ZEF Ndokilli Jubani. — *BREZI I RI Shkoder 19 Fruer 1925, Vjeta I, Nr. 4, fq. 22.*  
Artikull biobibliografik. Ndër të tjera shkruhet se Z. Jubani qe autor i një gramatike shqipe dhe i një alfabeti me shkronja latine. Në lidhje me problemin e gjuhës letrare të shqipes, autori shkruen se Z. Jubani ka çfaqë mendimin e vet në favor të të folmes së Elbasanit. Në fund botohet edhe një bibliografi e artikujve të shkrueme mbi Zef Jubanin.
1261. — ZOTO, XHAFER: The Albanian Language [Gjuha shqipe]. — *LABOREMUS Tirana February 1925, Vol. I, Nr. 4, fq. 2; Nr. 5, fq. 2; Nr. 7, fq. 1-2.*  
Artikull anglisht për historinë e gjuhës shqipe.—

